



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Më 02. 06. 2021

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Komuna e Vushtrrisë,

shpall

KONKURS LETRAR TË POEZISË

PËR FESTIVALIN “TAKIMET E POETESHAVE SHQIPTARE 2020”

Festivali “Takimet e Poeteshave Shqiptare” është festival tradicional dhe në këtë vit, në Vushtrri, mbahet Edicioni 39 i këtij festivali, andaj inkurajohen poetet shqiptare nga e gjithë bota që me poezitë e tyre të konkurrojnë, të bëhen pjesë e këtij festivali, i vetmi i këtij lloji në të gjitha hapësirat shqiptare.

Qëllimi i konkursit

- Ruajtja, kultivimi dhe zhvillimi i kulturës dhe letrave shqipe te femrat shqiptare;
- Nxitja, motivimi dhe promovimi i krijueseve shqiptare.

Kushtet për pjesëmarrje

- Poetet të konkurrojnë me emër dhe mbiemër dhe të jenë të moshës mbi 18 vjeç;
- Poetet të konkurrojnë vetëm me nga një poezi;
- Formati i shkronjave duhet të jetë: Mikrosoft Word, Time New Roman, 12
- Poezitë duhet të jenë në gjuhën shqipe, të pabotuara më parë;
- Poezitë të dërgohen vetëm përmes postës elektronike në adresën; **poetetshqiptare@gmail.com** (Secilës poete i konfirmohet pranimi i poezisë përmes postës elektronike);
- Poetet, së bashku me punimet e tyre t’i dërgojnë: dy numra kontakti (të qasshëm në çdo kohë), një biografi të shkurtër të krijimtarisë së poetes dhe një fotoportret;
- 21 poeteshat që do të përzgjidhen për të vazhduar në fazën e dytë të konkurrimit do të njoftohen me kohë për detajet tjera në lidhje me organizimin e Festivalit.

Afati i dërgimit

- Afati i dërgimit të poezive është i hapur **15 ditë**, nga dita e shpalljes.

Poezitë e arritura do të grumbullohen në dosje, pa të dhëna të autorësisë dhe vetëm me shifër, të cilën secilës poezi ia vendosë zyrtari i DKRS-së. Poezitë do të vlerësohen nga juria profesionale, e cila do të bëjë leximin dhe vlerësimin e poezive, pa pasur dijeni mbi autoren, por vetëm në bazë të shifrës, të cilën ia vendosë zyrtari i DKRS-së. Juria do të përmbyllë procesin e vlerësimit para datës së mbajtjes së festivalit, ndërsa ndarja e çmimeve do të bëhet në ditën e mbajtjes së festivalit. Për pjesëmarrje në festival do të kontaktohen vetëm poetet, poezitë e të cilave janë për zgjedhur për të vazhduar në fazën e dytë të konkurrimit.

Poetet që do të vazhdojnë konkurrimin do të njoftohen përmes telefonit dhe e-mail adresës, pas vlerësimit të poezive nga ana e jurisë profesionale, ndërsa ato poete që nuk ftohen do të thotë që poezitë e tyre nuk janë përzgjedhur nga juria për të vazhduar më tutje.

Në këtë festival do të ndahen këto çmime për poezi:

Çmimi i parë	500 €
Çmimi i dytë	300 €
Çmimi i tretë	200€
Debutuesja (poetja më e re në moshë që merr pjesë për herë të parë)	100 €

Për të gjitha poetet, poezitë e të cilave do të përzgjidhen nga juria, për pjesëmarrje në festival, organizatori mbulon shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit.

Për informata më të hollësishme mund të shkruani në e-mail adresën e lartshënuar.

Drejtoreshë e DKRS-së

Arta Ismajli

